



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.84/2017

Prishtinë, më 24.1.2017, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Rrustem Berisha, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Glauk Konjufca, zëvendëskryetar i parë, Sasha Milosavljeviç, zëvendëskryetar i dytë, dhe Blerim Grainca, anëtar.

Pjesëmarrës të tjerë: Dardan Abazi, INDEP; Etleva Malushaj, LVV; Fjolla Uka, KDI; Semra Tyrbedari, Ambasada e Britanisë së Madhe.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. 1 Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.12.2016;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
4. Formimi i grupit të punës për hartimin e nismës legislative: „Ligji për miniera dhe minerale”;
5. Miratimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2016;
6. Miratimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2017;
7. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Raif Qela– Propozoj që rendi i ditës të plotësohet edhe me një pikë tjetër: “Shqyrtimi i kundërshtive në mes të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor dhe Ligjit për kundërvajtje”.

Kryetari– Këtë çështje do ta diskutojmë në pikën, të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua, me ndryshimin që në pikën e shtatë: “Të ndryshme”, ku do të diskutohet çështja e ngritur nga deputeti Raif Qela.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhja e datës 27.12.2016

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 27.12.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryetari– Ju informoj se Kryesia e ka miratuar nismën tonë ligjore, në bazë të propozimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Gjithashtu, edhe Qeveria e ka mbështetur dhe asnjëri nga institucionet që e kanë trajtuar këtë nismë legjislative, nuk kane pasur asgjë kundër, por e kanë mbështetur këtë propozim tonin, si iniciativë ligjore të Komisionit.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin Projektligji nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

3. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

4. Formimi i grupit të punës për hartimin e nismës legjislative: “Ligji për miniera dhe minerale”

Kryetari– Meqenëse pas monitorimit të Ligjit për miniera dhe minerale, rekomandimi i Komisionit, por edhe i Kuvendit, ka qenë që në tremujorin e parë të bëhen ndryshime dhe plotësime në Ligjin për miniera dhe minerale, kërkoj nga Sala Berisha – Shala, e cila e ka

udhëhequr këtë grup të punës, që ta japë arsyetimin. Ndërkohë, kemi edhe një iniciativë nga deputeti Shaip Muja për ndryshimin e një neni të atij ligji, kështu që do të shohim tani se si do të procedojmë më tutje.

Sala Berisha – Shala– Siç e dini, Komisioni ka vendosur, në vitin e kaluar, që ta monitorojmë Ligjin për miniera dhe minerale. Ne, si grup i punës, e kemi monitoruar dhe të gjeturat i kemi të gjithë në raportin e punës gjatë monitorimit. Kuvendi ka miratuar rekomandimet që kanë dalë nga monitorimi i këtij ligji dhe një ndër rekomandimet është edhe hartimi i një ligji të ri për miniera dhe minerale. Meqenëse ky ligj, disa herë ka pësuar ndryshime dhe plotësime, tani të gjitha vërejtjet që kanë dalë nga monitorimi i ligjit, na shpjen në atë drejtim që të bëhet një ligj i ri. Ndërkohë, gjatë monitorimit të këtij ligji nga ana jonë, deputeti Shaip Muja e ka bërë një kërkesë për plotësimin dhe ndryshimin e këtij ligji, vetëm në një çështje, e cila ka dalë edhe si pjesë e monitorimit. Nga Qeveria, deputetit i është kthyer përgjigje se Kuvendi mund të vendosë, meqenëse Qeveria ka qenë e njoftuar me rekomandimet që kanë dalë nga monitorimi i ligjit dhe janë miratuar në Kuvend. Pra, këtë kompetencë ia ka deleguar Kuvendit, që i bie Komisionit në të cilin jemi ne. Kërkoj nga ju që ta diskutojmë së bashku, dhe nëse kemi vullnet, t'i hyjmë një ligji të ri për miniera dhe minerale nga ato rekomandime që kanë dalë, por natyrisht që nëse i hyjmë një nisme të tillë, atëherë duhet të bashkëpunojmë edhe me aktorë të tjerë edhe jashtë Kuvendit, si Ministria e Zhvillim Ekonomik dhe Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), sepse vijnë nga fushat përkatëse, pasi një ligj i tillë i hap rrugë zhvillimit të një segmenti shumë të rëndësishëm, siç është segmenti i minierave dhe mineraleve. Nëse ju e shihni të arsyeshme, e formojmë një grup të punës, pavarësisht nga ajo që ne kemi qenë një grup i punës, që e kemi bërë monitorimin e këtij ligji. Komisioni mund të formojë një tjetër grup të punës dhe një tjetër udhëheqës të këtij grupi.

Kryetari– Ky ligj nuk është i paraparë në Planin legjislativ të Qeverisë për vitin 2017. Kemi diskutuar gjatë trajtimit të raportit mbi monitorimin e këtij ligji. Ky është një ligj mjaft i rëndësishëm, nëse ne vendosim që të jemi iniciator të këtij ligji, duhet të jemi të vetëdijshëm që na pret shumë punë, ka shumë aktorë të interesuar për këtë çështje, është një ndër aktorët për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës, por nëse mendojmë që jemi të përgatitur, nuk kam asgjë kundër, por ne duhet ta zgjerojmë grupin e punës, dhe krahas Komisionit, patjetër duhet të jenë pjesë e grupit edhe organet kompetente brenda Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe zyrtarë adekuatë nga KPM, si dhe të shohim eventualisht ndonjë agjenci tjetër. Por, theksoj se është më mirë sikur ministria të vijë me një propozim, më tepër do të doja sikur të kishin qenë ndryshime dhe plotësime sesa që Komisioni ta marrë barrën e një ligji të ri, pasi që nuk kemi shumë resurse dhe duhet të angazhojmë ekspertë që e njohin këtë problematikë, të shohim përvojat e avancuara të vendeve tjera dhe ta bëjmë një ligj të mirë. Pra, nëse e marrim këtë barrë, ky është mendimi im, për fillim.

Besim Beqaj –Ne e kemi dhënë një rekomandim në Kuvend për nevojën e një ligji tjetër, dhe pse jo, ndoshta edhe të amendamentohet me plotësim- ndryshim. Në kohën e fundit, ka nisma të tjera ligjore të cilat bien ndesh me Ligjin për miniera dhe minerale. Siç e dini, i kemi pasur edhe ligjet, si Ligjin për Obiliqin, Ligjin për Trepçën etj. Pra, janë krijuar rrethana të reja, të cilat, parimisht, kërkojnë që ky ligj ose të ndryshohet, ose të bëhet një ligj i ri. Në këtë drejtim, besoj që do të ishte mirë që të lëvizim parimisht dhe do të ishte më mirë që ky ligj të ishte pjese e agjendës legjislative të Qeverisë se sa ne të marrim këtë barrë, jo pse ne nuk kemi vullnet, dëshirë dhe

përkushtim për të bërë një ligj të mirë, por jam skeptik në kapacitete përcjellëse të Komisionit, sepse duhet bërë një analizë të ndërthurtë me të gjitha ligjet tjera. Pra, duhet të ketë një zyrë ligjore, e cila ka kompetencë profesionale që duhet të sigurojë që ligji të mos bie në kolizion me ligjet tjera. Pra, është proces mjaftë kompleks dhe nëse ne vendosim që ta marrim këtë iniciativë, duhet të kemi në grup të punës, përveç Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe KPMM-së, ta kemi edhe Zyrën Ligjore të Kryeministrit, ku përfshihet edhe Zyra për Planifikim Strategjik, sepse ata e kanë pasqyrën e qartë të ligjeve, më mirë sesa që e kemi ne këtu, si dhe duhet të jetë edhe dikush nga ekspertët e pavarur që të kemi një ekip të mirë. Unë në parim pajtohem që të kemi një ligj të ri, por ta diskutojmë se a është e rrugës që ta bëjmë ne apo të kërkojmë nga ministria, duke e amendamentuar planin legjislativ të ministrisë dhe kjo të kalojë edhe në Qeveri dhe të marrin në planin legjislativ edhe aktivitetin tonë. Nëse ne dëshirojmë të marrim primatin, atëherë duhet të kemi angazhim maksimal. Sa i përket nismës së deputetit Shaip Muja, është e njëjta çështje, pra duhet të integrohet në kuadër të kësaj dhe mund t'i ngërthejmë të gjitha në një vend, edhe pse kjo sigurisht mund të marrë diku 4-5 muaj për të ardhur në përfundim dhe kompletim të një ligji funksional dhe do ta ndihmonte industrinë.

Fatmir Rexhepi – Pas këtyre kërkesave, që ky ligj të ndryshohet në masë të madhe ose edhe të bëhet një ligj i ri, duhet t'i mbetet ekskluzivisht detyrë e Qeverisë. Pra, projektligjin e ri ta hartojë Qeveria, për arsye se i ka të gjitha kapacitetet dhe është detyrë e saj të shohë harmonizimin, me të gjitha ligjet tjera, kurse nëse mendohet të bëhet ndonjë amendamentim shtesë, në kuadër të ligjit ekzistues, atëherë mund ta bëjë Komisioni, në bashkëpunim me stafin dhe ekspertët tjerë.

Raif Qela – Nevoja për plotësim-ndryshim ose për ligj të ri për miniera dhe minerale, është e domosdoshme, sepse nga të gjeturat e monitorimit nga grupi i punës në terren, është parë se ka shumë zbrazëti në këtë ligj. Si rezultat, ne duhet të bëjmë përpjekje që ato zbrazëtira t'i eliminojmë sa më parë. Meqenëse disa prej atyre zbrazëtirave janë shumë urgjente, ia vlen që të hyjmë në plotësim-ndryshim, sepse edhe ashtu mendoj që Komisioni, respektivisht Kuvendi, është shumë vështirë që një ligj bazik kaq të rëndësishëm, ta bëjë vetë. Mendoj që për plotësim-ndryshim të ligjit kemi kapacitete, por jo edhe për ligj të ri, sepse kërkohen kapacitete që ne nuk i kemi.

Sala Berisha – Shala – Në Qeveri, angazhojnë ekspertë të fushave të tjera të caktuara në hartim të ligjeve. Pra, është dashur që në fillim, si Komision, kur e kemi paraqitur në Kuvend, si grup i punës në Komision, tek rekomandimet, të themi që nuk pajtohemi me rekomandimin e parë, i cili thotë: *“Kuvendi i Republikës së Kosovës, në afat prej tre muajsh, të marrë nismën legjislative për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për miniera dhe minerale”*, dhe nuk është ndonjë frikë se ne më lehtë bëjmë plotësim-ndryshim sesa të bëjmë një nismë të re ligjore. Ne e kemi bazamentin e këtij ligji, sepse është ligji që është në fuqi, është drafti që e ka punuar KPMM-ja, që është mekanizmi më adekuat që e zbaton këtë ligj, dhe në bashkëpunim me ata, ne mund ta bëjmë këtë ligj. Si të doni mund të vendosim, por, ne, që në fillim po i shmangemi rekomandimit të parë që e kemi miratuar në Kuvendin e Kosovës, përndryshe ashtu si do të vendosë Komisioni, natyrisht se do ta mbështes.

Kryetari – Deputetja Sala Berisha – Shala, e potencoi se ka shumë ndryshime dhe shumë nene, që duhet ndryshuar. Pra, nëse veç hyjmë kështu, më mirë është të bëjmë një ligj konsistent. Propozoj që ne t'ia dërgojmë një shkresë ministrisë nga mbledhja e sotme, të përshkruajmë

rekomandimin e Kuvendit, të përshkruajmë debatin që patëm sot dhe të kërkojmë një mendim të tyre, dhe në mbledhjen e ardhshme, vendosim varësisht nga përgjigja e ministrisë, por më e rëndësishmja është që ligji duhet të kryhet.

Pas debatit, Komisioni nxori:

Përfundim

Para se të merret vendim për nismën legislative: “Hartimi i Ligjit për miniera dhe minerale”, në përputhje me Rekomandimin e Kuvendit, të kërkohet një opinion konsultativ nga Ministria për Zhvillim Ekonomik.

5. Miratimi i Raportit vjetor të Punës së Komisionit për vitin 2016

Kryetari– Ju e keni marrë raportin e hartuar nga stafi mbështetës i Komisionit, i udhëhequr nga Armend Ademaj. Mendoj se raporti ka përfshirë në tërësi aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit të kaluar. Shihet që kemi pasur një mori aktivitete të rëndësishme. Në raport është një pasqyrë e përmbledhur dhe mendoj që kemi bërë një avancim të punës sonë, sa i përket komunikimit me agjenci të pavarura dhe me biznese. Trajtimi i çështjeve që kanë një natyrë pak më gjithëpërfshirëse ekonomike dhe jo vetëm ligjet. Monitorimi i ligjeve, 4 (katër) punëtori, 40 (dyzet) mbledhje me 204 (dyqind e katër) pika të rendit të ditës. Ligjet tona, që janë diku 35% deri në 40% të ligjeve të miratuara në Kuvend, gjë që flet për një angazhim dhe unë i falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit edhe për atmosferën e punës, edhe për angazhimin dhe për punën që kemi bërë. Natyrisht, që çdoherë kemi mundësi që ta avancojmë punën në disa drejtime, mirëpo gjithmonë të mbetemi që pikë qendrore e aktiviteteve tona, të jetë rritja ekonomike dhe krijimi i mjedisit për investime dhe punësim. Ne kemi 14 (katërmëdhjetë) raportime të ministrave ose përfaqësuesve të ministrive, gjë që tregon për një aktivitet të monitorimit të ministrive dhe besoj se duhet ta forcojmë në të ardhmen.

Sala Berisha – Shala– Konsideroj që Komisioni ka kryer punë të mëdha. Ka pasur projekte të ngjeshura dhe nuk besoj që ndonjë komision tjetër të ketë bërë punë sa ne. Si Komision, besoj që kemi përfunduar punët me sukses. Ajo që desha të cekë është se sa i përket vizitave jashtë vendit, nuk është përfshirë vizita ime në Kanada, më 5-9 mars 2016. Konsideroj që ka qenë vizitë shumë e rëndësishme dhe dua të rikujtoj se në atë konferencë, Kosova për herë të parë është bërë anëtare e Asociacionit të Forumit Ekonomik të NATO-s, me të drejta të barabarta, si dhe ka pasur një prezantim për resurset minerale të Kosovës.

Besim Beqaj– Besoj që, nëse e krahasojmë planin e punës, të cilin e kemi pasur edhe në raportin e punës, në disa raste, ka dalë që ne kemi bërë punë, të cilat nuk i kemi pasur të parapara me plan, por që realisht ne i kemi përfunduar me sukses. Dua t’i falënderoj të gjithë deputetët për bashkëpunim, me të cilët i kemi tejkaluar dallimet pozitive-opozitive dhe kemi pasur frymë bashkëpunimi, që është shumë e rëndësishme për punën e Komisionit. Gjithashtu, edhe stafi ka bërë një punë të shkëlqyeshme dhe dua t’i falënderoj edhe ata për punën e tyre.

Raif Qela– Komisioni nga buxheti prej 5000 euro, për vitin 2016, ka shpenzuar shumën prej 2.660 euro, ku prej tyre 1.000 euro për ekspertiza, ndërkaq 1.660 euro për shpenzime reprezentative në mbledhje, punëtori dhe takime zyrtare të Komisionit.

Kryetari– Sa i përket çështjes së buxhetit, mendoj se edhe këtë vit, ne do të kemi buxhet të njëjtë. Po shihet që d.m.th. prej buxhetit 5000 euro, ne kemi shpenzuar 2660, prej të cilave 1000 euro për ekspertiza dhe 1060 për këto shpenzimet tona, për mbledhje, takime zyrtare etj. Në të ardhmen, krahas kësaj sjelljeje racionale, ndoshta mund të rrisim më shumë ekspertizën. Pra, të kemi ekspertiza dhe aktivitete më të mëdha, në dobi të punës, ta pasurojmë punën tonë dhe ta bëjmë më cilësore, por që do të ketë edhe kursim.

Sala Berisha- Shala– Sigurisht, se në favor të funksionalizimit të punës sonë, nuk duhet ta kursejmë as buxhetin.

Pas debatit, Komisioni nxori:

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i punës së Komisionit për vitin 2016.

6. Miratimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2017

Kryetari– Sa i përket Planit të punës së Komisionit për vitin 2017, që e kemi marrë draftin e këtij plani të hartuar, po ashtu, nga stafi administrativ i Komisionit, në krye me koordinatorin Armend Ademaj. Këta e kanë ndjekur Strategjinë legjislativë të Qeverisë, kanë futur edhe disa aktivitete të jashtëzakonshme që i kemi dhe kanë dhënë propozime. Mendoj se këto planifikime për vizitat që i kemi në agjenci, vizita me asociacionet dhe me bizneset, të hyjnë në një pikë, që ne i bëjmë gjatë gjithë vitit, jo në një datë të caktuar, por kur të kemi mundësi që t'i bëjmë gjatë tërë vitit. Tjetër, ne duhet ndonjëherë, krahas ligjeve, të kemi edhe disa tema që të zhvillojmë debat pak më përmbajtësor, sikurse në vitin e kaluar, konkretisht një temë për investimet, p.sh. investimet e brendshme e të jashtme, për ecuritë e të dhënave dhe rritjen ekonomike, si po shkojnë investimet dhe rritja ekonomike, një temë tjetër një mbledhje janë këmbimet tregtare, eksportet dhe importet, si po shkon puna, ku janë problemet, një mbledhje për zhvillimet në energji, furnizimin me energji dhe një mbledhje, ndoshta për të diskutuar lidhur me realizimin e planit të ndërtimit të rrugëve në infrastrukturë. Këto ishin propozimet e mia, që i kishim shpërndarë, përndryshe raportimet vazhdojnë qysh i kemi pasur viteve të tjera. Me këto propozime, unë po hap diskutimin. Kërkoj nga stafi i Komisionit që ta përgatisë një plan për mënyrën e shpenzimit të buxhetit të Komisionit, në bazë të aktiviteteve të planifikuara.

Rrustem Berisha– Sa i përket këtij plani të punës për vitin 2017, ne e kemi analizuar këtë plan dhe ka shumë aktivitete që janë paraparë, të cilat ne i përkrahim. Ajo që na ka ra në sy, mendoj që ishte dashur të jetë pjesë e këtij plani të punës, është monitorimi i marrëveshjeve të koncesionit të aeroportit, postës, KEDS-it, vërtet për të parë se sa po zbatohen këto marrëveshje dhe sa po respektohen në praktikë. Po ashtu, ishte dashur që të shohim ose të mbikëqyrim zbatimin e Ligjit për Trepçën, që besoj se në gjashtëmujorin e dytë, sigurisht që do të fillojë së zbatuari, po ashtu edhe Ligji për komunikacionin, pra edhe ky ishte dashur që të jetë një çështje, e cila është shumë vështirë e zbatueshme, në harmonizim me Ligjin për kundërvajtje.

Besim Beqaj– Do ta përmend se çështja e energjisë dhe njëfarë forme të angazhimit tonë, sa i përket furnizimit me energji, ndoshta një fokus tek energjia do të duhej të bëhej që sa më shpejt që është e mundur, të bëhet monitorimi i investimeve, të cilat KEDS-i i bën në rrjet dhe këtu një fokus të veçantë do të duhej të trajtohej furnizimi me trafo. Sepse, kemi plot raste kur trafotë financohen nga qytetarët, dhe në momentin kur trafo lëshohet në përdorim, ajo bëhet pronë e KEDS-it, si aset i saj, që parimisht nuk do të duhej që qytetarët të paguajnë për trafo, por duhet që KEDS-i ta bëjë një investim të tillë ose t'u zbriten faturat, pra duhet të ketë një mekanizëm. Kam biseduar edhe me rregullatorin dhe kisha dashur që ndoshta ta thërrasim edhe rregullatorin dhe të bisedojmë për këtë temë dhe ta orientojmë sa më shpejt.

Duda Balje– Pikërisht, në këtë temë, problem është edhe ujësjellësi, ku në një numër të madh fshatrash në Kosovë, ujësjellësi është bërë nga investimet personale të banorëve, pastaj ata janë ngarkuar me pagesë të ujit, që do të thotë që duhet të paguajnë vetë. Unë di më së paku 24 fshatra në rrethinën e Prizrenit, të cilat vetë e kanë bërë sistemin e ujësjellësit.

Sala Berisha– Shala– Në plan të punës është paraparë shqyrtimi i raportit të ndërmarrjeve publike të vitit 2015, kurse shqyrtimi i raportit për vitin 2016, është paraparë më vonë. Pra, në muajin shtator, po mendoj a është më mirë që të bëhet në të njëjtën kohë, shqyrtimi i të dy raporteve dhe të shohim se sa ka lëvizur performanca e tyre.

Enver Hoti– Mendoj se shqyrtimi i raportit të ndërmarrjeve publike, duhet të mbetet kështu, siç është.

Raif Qela– Vetëm, tek mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për digjitalizimin e transmetimeve radio-difuzive, duhet t'i shtohet edhe fjala “tokësore”, sepse ligji e ka emrin ashtu.

Kryetari– Propozoj që t'i inkuadrojmë këto propozime, që i dhanë deputetët, konkretisht tek çështja e temave që i dhashë unë, duhet t'i fusim tash, që në çdo dy apo tre muaj, të kemi nga një temë pak më të përgjithshme dhe jo vetëm ligje, vetëm teknike, por monitorimin e shumë ligjeve, shumë politikave, a po zbatohen në fushën e caktuar, shembull tek investimet, tek deficitit tregtar, furnizimi me energji etj. Propozimi i deputetit Berisha, mendoj që duhet të kërkojmë që kur të na vijë raporti, të jetë një trajtim i posaçëm aty, për zbatimin e kontratave. Pra, krahas raportit në muajin shkurt që e kemi, t'i dërgojmë një shkresë ministrisë, që të na dërgojë raportin mbi zbatimin e kontratave në KEDS dhe aeroport.

Besim Beqaj– Pajtohem që ne duhet të monitorojmë dhe të jemi sa më vigjilentë, por mbi bazën e ligjeve, ato monitorohen nga institucionet, të cilat janë të thirrura dhe mund t'i penalizojnë, në rast se nuk i kanë zbatuar kontratat, ndërsa ne mund të shkojmë t'i verifikojmë, se a janë marrë aktivitetet apo nuk janë marrë, mirëpo monitorim të drejtpërdrejtë neve nuk na lejon ligji.

Rrustem Berisha – Cili ligj nuk na lejon?

Besim Beqaj– Parimisht, marrëveshja bëhet në mes të organeve ekzekutive dhe organeve, të cilat, në këtë rast, janë koncesionare. Pra, ata japin raport me shkrim dhe ne duhet të kërkojmë raport me shkrim prej Qeverisë. Ne mund të informohemi pastaj në detaje, sepse nuk mund të na ndalojë askush, që të shkojmë për t'i vizituar dhe të kërkojmë prej Qeverisë, aktivitet. Këtë po e them që

një aktivitet institucional të monitorimit, nuk e kemi dhe nuk na sanksionon ligji. Ne, edhe po të shkojmë për monitorim, nëse s'kanë bërë diçka, çka mund të bëjmë? Meqenëse nga deputetja u ngrit çështja e ujit dhe investimeve në këtë sektor, ndoshta do të duhej që në shkurt, ta bëjmë një takim. Sa i përket investimeve në sektorin publik, kisha kërkuar që ta bëjmë një diskutim, t'i thërrasim sesi trajtohen bizneset private, të cilat janë në funksion të shërbimeve publike, e që ka shumë.

Kryetari– Mendoj që duhet të kërkojmë informim apo raport me shkrim për zbatimin e kontratave me koncesionim, pra koncesionimi i aeroportit dhe KEDS-it, dhe mandej prej aty, nëse ka nevojë, ne mund të formojmë ndonjë grup, për të bërë ndonjë mbikëqyrje më të thellë.

Rrustem Berisha– E shoh, si shumë të nevojshme dhe ka shumë ankesa të shumta të qytetarëve. Unë dua ta di se si një deputet nuk ka të drejtë të kërkojë informata sesi po zbatohen kontratat, deputeti ka të drejtë. Pastaj, nëse e vlerëson se nuk është duke u zbatuar si duhet, ta ngre çështjen në Kuvend dhe pastaj ato institucione t'i japin llogari Kuvendit. Nëse nuk kontrollohet, nuk duhet të mendojmë se po shkon çdo gjë në rregull.

Kryetari– Mendoj se këtu, gati të gjithë po mendojmë njëjtë. Qeveria dhe ministria ka përgjegjësinë ta monitorojë zbatimin e kontratave. Ne duhet të kërkojmë përgjegjësi prej tyre.

Rrustem Berisha– Nëse ju po vlerësoni se është problem dhe se duhet të mbahet fshehtë, unë e tërheq propozimin tim, por ky është qëndrimi ynë, si opozitë, pra i Aleancës. Ne e kemi diskutuar, kemi pasur probleme me KEDS-in, ka probleme me aeroport. Pse ne të zgjedhurit e popullit nuk kemi të drejtë të monitorojmë? Nuk po ua marrim përgjegjësinë ministrive, por edhe ato ministri duhet t'i japin llogari dikujt, dhe nëse shohim që ka diçka, e ngremë si çështje.

Besim Beqaj– Një sqarim, intervenimi im për këtë ishte që ne nuk kemi autoritet institucional për monitorim dhe është dallim substancial të kesh autoritet institucional për monitorim dhe të drejtë për ta vizituar dhe për t'u informuar. Autoriteti ynë institucional, mbi bazën e kontratës, nuk ekziston, si Kuvend. Ne kemi të drejtë t'i monitorojmë ministrinë, të cilat na përgjigjen neve dhe përmes tyre, t'i monitorojmë edhe të tjerët, por deputetit nuk mund t'ia ndalojë askush, sepse deputeti ka të drejtë që ta ngre çdo shqetësim të qytetarëve.

Kryetari– E fusim si pikë të veçantë: “Shqyrtimi i raporteve mbi zbatimin e kontratave të koncesionimit të aeroportit dhe të privatizimit të KEDS-it” dhe do ta realizojmë.

Raif Qela– Ne e dimë se në tregun kosovar ka probleme të mëdha me monopolin, dhe si rezultat i kësaj, ne duhet të shohim se sa është duke u angazhuar Komisioni i Konkurrencës, për ta luftuar monopolin. Për këtë arsye, unë mendoj se në pjesën e parë të vitit 2017, duhet ta thërrasim Komisionin e Konkurrencës, për shkak të një morie problemesh.

Kryetari– Këtë çështje e trajtojmë në raportim për raportin vjetor, sepse në muajin mars vjen raporti vjetor nga Komisioni i Konkurrencës.

Pas debatit, Komisioni nxori:

Përfundim

1. *Miratohet Plani i punës së Komisionit për vitin 2017.*
2. *Stafi mbështetës i Komisioni ta përgatisë një plan për mënyrën e shpenzimit të buxhetit të Komisionit.*

7. Të ndryshme

Shqyrtimi i kundërshtive në mes të Ligjit për Rregullat e trafikut rrugor dhe Ligjit për kundërvajtje

Raif Qela– Ligji për kundërvajtje konsiderohet si ligj bazik dhe ligjet tjera do të ishte dashur të harmonizohen me këtë ligj. Ligji për rregullat e trafikut rrugor është miratuar për afërsisht në të njëjtën kohë, me këtë ligj. Gjatë kësaj kohe, ka qenë pjesë e grupit të punës edhe përfaqësuesi i Komisionit për Legjislacion. Megjithatë, ata nuk kanë dhënë vërejtje. Por, duke pasur parasysh se është shumë më funksionale, që kufiri në të cilin një polic i trafikut rrugor mund ta dënojë, të konsiderohet si kufi shuma prej 60 (gjashtëdhjetë) eurosh dhe jo më shumë, edhe për shkak të rrezikut dhe mos të korruptohen pjesëtarët e policisë, ne e kemi lënë këtë kufi prej gjashtëdhjetë 60 eurosh, kurse në Ligjin për kundërvajtje, është deri në 500 (pesëqind) euro për persona fizikë dhe deri në 1000 (njëmijë) euro për persona juridikë. Si pasojë e kësaj, mbesin shumë lëndë të pa-ekzekutuara, prej 60 (gjashtëdhjetë) deri në 500 (pesëqind) euro, respektivisht 1000 (njëmijë) euro dhe ka filluar që kjo çështje të bëhet problem. Ne mund ta ndryshojmë Ligjin për rregullat e trafikut rrugor, mirëpo po të mbetet kështu siç është Ligji për kundërvajtje, kjo afekton edhe në një mori ligjesh tjera, diku 7 (shtatë) ose 8 (tetë) ligje tjera. Këtë ma tha edhe përfaqësuesi i Policisë, i cili ka qenë në shqyrtimin e Ligjit për rregullat e trafikut rrugor, major Jeton Rexhepi. Është shumë më e rrugës, që ta shqyrtojnë Ligjin për kundërvajtje, ta amendamentojmë, sepse është shumë e logjikshme, që mos t'i lihet policisë, shuma prej 500 (pesëqind) eurosh që të dënojë, se ata nuk i kanë kapacitetet njerëzore, sepse, megjithatë, duhet të kenë njohuri se cilat janë rrethanat lehtësuese, pastaj rrethanat renduese etj., rrethana të cilat janë mjaftë të rënda që policia t'i kryejë. Pra, mendoj se ishte dashur që Ligji për kundërvajtje, të ndryshojë, dhe jo të ndryshohen të gjitha këto ligje tjera, që afektojnë me këtë ligj.

Kryetari– Propozoj që deputeti Raif Qela, të ngarkohet me këtë çështje, pasi që ka qenë edhe kryesues i grupit të punës për shqyrtimin e Projektligjit për rregullat e trafikut rrugor.

Komisioni vendosi që deputeti Raif Qela, të kontaktojë me Komisionin për Legjislacion dhe mandej të vendoset për këtë çështje.

Mbledhja përfundoi në ora 14:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa